

Vendim nr. 295 datë 11.11.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 11.11.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (Xh) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: XHELADIN XHEKALIU

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-411, datë 06.03.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 21, 22 dhe 23 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është babai i një shtetasi i cili ka humbur jetën në një aksident automobilistik të ndodhur në datën 24.07.2024 në Tiranë. Pas disa ditësh, në datën 02.08.2024, drejtuesi i automjetit që ka shkaktuar aksidentin është vetëdorëzuar në polici dhe është ndaluar. Për këtë ngjarje, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në datën 03.08.2024, ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të të ndaluarit për veprat penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” dhe “Largimi nga vendi i aksidentit”, të parashikuara, respektivisht, nga nenet 290, paragrafi i tretë, 291 dhe 273 të Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 1969 akti, datë 04.08.2024, ka vendosur vleftësimin e paligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, me argumentin se i ndaluari nuk kishte asnjë rrezik ikjeje. Në nxjerrjen e këtij konkluzioni, gjykata ka evidentuar se i ndaluari ishte dorëzuar vetë në polici, asnjë nga palët nuk kishte paraqitur kallëzim, i ndaluari sapo kishte mbushur moshën 18 vjeç, ishte nxënës në shkollë të mesme dhe nuk kishte asnjë indicie për ikje ose fshehje të tij.

3. Ndonëse vendimi është kundërshtuar nga familjarët e viktimës së aksidentit, përfshirë edhe kërkuesin, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 2418 (30-2024-7407), datë 15.10.2024, ka vendosur mospranimin e ankimit. Po kështu, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-411, datë 06.03.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit.

4. Në datën 29.07.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 21.08.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar:

5.1. *Të drejtën e jetës*, të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës, pasi shteti ka detyrimin pozitiv për të mbrojtur jetën e individit. Djali i tij ka qëndruar në gjendje kome për 8 ditë derisa ndërroi jetë, ndërsa personi që shkaktoi aksidentin vazhdon të jetë i lirë.

- 5.2. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në aspekt të së drejtës për t'u njoftuar dhe për t'u dëgjuar, pasi familjarët e viktimës janë përjashtuar nga proceset gjyqësore. Gjykatat dhe prokuroria nuk kanë zbatuar ligjin në drejtim të paanshmërisë dhe transparencës, duke shkelur nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës. Prindërve dhe fëmijëve të mitur u është hequr e drejta për mbrojtje gjyqësore, ndërsa e ëma e tyre ndiqet penalisht nga prokuroria, ndonëse nuk ka pasur asnjë faj në aksidentin e ndodhur. Vendimi për të lënë të lirë të pandehurin përmbi 1 vit është marrë në mënyrë subjektive dhe pa respektuar procedurat ligjore.
- 5.3. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi është manipuluar shpejtësia e automjetit, është ndryshuar ora e aksidentit dhe është fshehur e vërteta. Vendimi është marrë nën ndikim dhe korrupsion, sepse personi që ka shkaktuar aksidentin është djali i ish-kryetarit të komunës disa legjislatura përpara vitit 2015. Po kështu, edhe prokurori i çështjes është i korruptuar, pasi ka bërë dy gjykime brenda ditës.
- 5.4. *Pavarësinë e gjykatës*, të garantuar nga neni 145 të Kushtetutës, pasi mosarrestimi përbën shkelje të detyrimeve të shtetit për mbrojtjen e të drejtave themelore. Ky është mosndëshkim efektiv për veprat penale që i morën jetën djalit të tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

6. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se ai nuk legjitimohet për të kundërshtuar vendimin gjyqësor që ka caktuar masën e sigurimit personal, ndaj një personi nën hetim për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 273, 290, paragrafi i tretë dhe 291 të KP-së. Kërkuesi ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës së jetës, për proces të rregullt ligjor (në aspekt të së drejtës për t’u njoftuar, për t’u dëgjuar, paanshmërisë dhe transparencës), barazisë përpara ligjit dhe pavarësinë e gjykatave, mbështetur në argumentin kryesor se vendimi gjyqësor që ka disponuar masën e sigurimit personal të detyrimit për t’u paraqitur të shkaktarit të aksidentit, në të cilin ka mbetur viktimë djali i tij, duke e lënë të lirë autorin mbi 1 vit, është i padrejtë, është marrë në mënyrë subjektive, nën ndikime të paligjshme dhe pa respektuar procedurat ligjore.

9. Ndërkohë, gjykata e apelit ka arsyetuar se kërkuesi nuk legjitimohet në paraqitjen e ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka caktuar masën e sigurimit, pasi viktima ka të drejtën e ankimit vetëm ndaj vendimit të prokurorit që ka vendosur mosfillimin e procedimit penal dhe të vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për pushimin e akuzës ose të çështjes. Sipas gjykatës së apelit, ligji nuk parashikon të drejtën e viktimës për të ushtruar ankim kundër vendimit për caktimin e masës së sigurimit personal, pasi kjo e drejtë i njihet vetëm prokurorit dhe të pandehurit ose mbrojtësit të tij të pajisur me prokurorë ku është i shprehur delegimi i së drejtës së ankimit. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Lartë, e cila është shprehur se kufizimi i së drejtës së viktimës për të kundërshtuar vendimin për caktimin e masës së sigurimit është taksativ.

10. Në analizë të vendimeve gjyqësore, Kolegji nuk evidenton gabime ligjore ose faktike në vlerësimin e gjykatave të tilla që të vënë në dyshim konkluzionin e tyre. Në këtë pikë, Kolegji vë në dukje se e drejta e jetës nuk është objekt i drejtpërdrejtë i procesit gjyqësor të caktimit të masës së sigurimit personal, por i procesit të themelit, i cili ende nuk ka përfunduar. Lidhur me ecurinë e këtij të fundit, kërkuesi, në cilësinë e familjarit të afërt të viktimës, ka të drejtë të ngrejë pretendime, pasi siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, një përgjigje efektive nga organet e ndjekjes penale me veprime hetimore të shpejta, të plota dhe të orientuara drejt e kujdesshëm në zbatimin e duhur të ligjit për të siguruar mbrojtjen e së drejtës së jetës është thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut, respektimin e shtetit të së drejtës dhe parandalimin e akteve të paligjshme (shih vendimin nr. 42, datë 29.05.2024 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se në rastin konkret kërkuesi, nga pikëpamja substanciale, nuk justifikon interesin e drejtpërdrejtë, ndaj nuk legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës. Në këto kushte, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë së ankimit bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

12. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.